

# Direktiva 2002/58/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit

e datës 12 korrik 2002

*Lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike (Direktiva mbi Privatësinë dhe Komunikimet Elektronike)*

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, dhe në veçanti nenin 95,

Duke pasur parasysh propozimin nga Komisioni (1),

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik Social (2),

Pas konsultimit të Komitetit të regjioneve,

Duke vepruar në përputhje me procedurat e shtruara në nenin 251 të Traktatit (3),

Duke pasur parasysh që:

(1) Direktiva 95/46/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 tetor 1995 për mbrojtjen e individëve për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla (4) kërkon nga shtetet anëtare që t'i sigurojë të drejtat dhe liritë e personave fizikë për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe në veçanti të të drejtës së tyre në privatësi, në mënyrë që të sigurohet rrjedha e lirë e të dhënave personale në komunitet.

(2) Kjo direktivë kërkon respektimin e të drejtave fundamentale dhe mbikëqyrë parimet e pranuar në veçanti nga Karta e të Drejtave Fundamentale e Bashkimit Evropian. Në veçanti, kjo direktivë kërkon që të sigurojë respektimin e plotë për të drejtat e përcaktuara në nenet 7 dhe 8 të Kartës.

(3) Konfidencialiteti i komunikimeve është i garantuar në pajtim me instrumentet ndërkombëtare që lidhen me të drejtat e njeriut, në veçanti me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtat Fundamentale, si dhe me kushtetutat e shteteve anëtare.

(4) Direktiva 97/66/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 dhjetor 1997 lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe me mbrojtjen e privatësisë në sektorin e telekomunikimeve (5) ka përkthyer parimet e përcaktuara në Direktivën 95/46/EC në rregulla specifike për sektorin e telekomunikimeve. Direktiva 97/66/EC duhet t'i përshtatet zhvillimeve në treg dhe teknologjisë së shërbimeve të komunikimeve elektronike në mënyrë që të sigurojë nivel të barabartë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë për përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut, pavarësisht nga teknologjia e përdorur. Prandaj ajo direktivë duhet shfuqizuar dhe zëvendësuar me këtë direktivë.

(5) Teknologji të reja e të përparuara dixhitale po prezentohen aktualisht në rrjetet e komunikimit publik në komunitet, të cilat rrisin kërkesat specifike për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së përdoruesit. Zhvillimi i shoqërisë informative karakterizohet me paraqitjen e shërbimeve të reja të komunikimeve elektronike. Qasja në rrjetet mobile dixhitale është vënë në dispozicion dhe është bërë e përballeshme për publikun e gjerë. Këto rrjete dixhitale kanë kapacitete dhe mundësi të gjera për përpunimin e të dhënave personale. Zhvillimi ndërkufitar i suksesshëm i këtyre shërbimeve varet pjesërisht nga besimi i shfrytëzuesve që privatësia e tyre nuk do të rrezikohet.

(6) Interneti po i përmbytë strukturat e tregut tradicional duke ofruar një strukturë të përbashkët globale për dërgimin e shërbimeve të gjera të komunikimeve elektronike. Shërbimet e komunikimit elektronik në dispozicion të publikut në internet hapin mundësi të reja për përdoruesit, por edhe rreziqe të reja për të dhënat personale dhe privatësinë e tyre.

(7) Në rastin e rrjeteve të komunikimeve publike, duhen sjellë dispozita specifike ligjore, rregulluese dhe teknike në mënyrë që të mbrohen të drejtat dhe liritë fundamentale të personave fizikë dhe të interesave legjitimë të personave juridikë, në veçanti për sa i përket kapacitetit në rritje për ruajtje dhe përpunim të automatizuar të të dhënave të lidhura me abonuesit dhe përdoruesit.

(8) Dispozitat ligjore, rregulluese dhe teknike të miratuara nga shtetet anëtare për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, privatësisë dhe interesave legjitimë të personave fizikë në sektorin e komunikimit elektronik, duhen harmonizuar në mënyrë që të shmangen pengesat në tregun ndërkombëtar për komunikime elektronike në pajtim me nenin 14 të Traktatit. Harmonizimi duhet të jetë i kufizuar në kërkesat e nevojshme për të garantuar se promovimi dhe zhvillimi i shërbimeve të reja të komunikimeve elektronike dhe rrjeteve midis shteteve anëtare të mos pengohet.

(9) Shtetet anëtare, për sa u përket ofruesve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve, bashkë me organizmat kompetentë të komunitetit, duhen bashkëpunuar në paraqitjen dhe zhvillimin e teknologjive relevante ku është e nevojshme të aplikohen garancitë e ofruara nga kjo direktivë dhe duke marrë parasysh në veçanti objektivat e minimizimit të përpunimit të të dhënave personale dhe të përdorimit të të dhënave anonime dhe pseudonimet aty ku është e mundshme.

(10) Në sektorin e komunikimeve elektronike, Direktiva 95/46/EC aplikohet në veçanti në të gjitha çështjet e lidhura me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale, të cilat nuk mbulohen në mënyrë specifike me dispozitat e direktivës, përfshirë obligimet mbi kontrolluesin dhe të drejtat e individëve. Direktiva 95/46/EC aplikohet ndaj shërbimeve të komunikimeve jopublike.

(11) Si Direktiva 95/46/EC, kjo direktivë nuk adreson çështjet e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive fundamentale të lidhura me aktivitetet të cilat nuk rregullohen me ligjin e komunitetit. Prandaj nuk e ndryshon balancin ekzistues midis të drejtës së individit në privatësi dhe mundësisë për shtetet anëtare për të ndërmarrë masat e referuara në nenin 15(1) të kësaj direktive, të domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë publike, mbrojtjes, sigurisë së shtetit (përfshirë mirëqenien ekonomike të shtetit kur aktivitetet lidhen me çështjet e sigurisë së shtetit) si dhe zbatimin e ligjit penal. Si pasojë, kjo direktivë nuk ndikon në aftësinë e një shteti anëtar për të kryer përgjime të ligjshme të komunikimeve elektronike, apo të marrë masa tjera, nëse është e nevojshme për cilindo qëllim dhe në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të

Drejtave të Njeriut dhe Liritë Fundamentale, siç është interpretuar nga vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Masat e tilla duhet të jenë të përshtatshme, saktësisht proporcionale me qëllimin e synuar dhe të domosdoshme brenda një shoqërie demokratike dhe duhet ti nënshtrohet ruajtjes adekuate në pajtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale.

(12) Abonuesit në shërbimet e komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut mund të jenë persona fizikë apo juridikë. Duke plotësuar Direktivën 95/46/EC, direktiva synon mbrojtjen e të drejtave fundamentale të personave fizikë dhe në veçanti të drejtën e tyre në privatësi, si dhe interesat legjitimë të personave juridikë. Kjo direktivë nuk e lë si detyrim obligimin për shtetet anëtare që të zgjerojë aplikimin e Direktivës 95/46/EC për mbrojtjen e interesave legjitimë të personave juridikë, që është siguruar brenda kornizës së aplikueshme të komunitetit dhe legjislacionit nacional.

(13) Marrëdhënia kontraktuale midis abonuesit dhe ofruesit të shërbimeve mund të detyrojë një pagesë periodike apo të kryer vetëm një herë për shërbimin e ofruar apo që duhet ofruar. Kartelat e parapagimin gjithashtu konsiderohen si kontratë.

(14) Të dhënat e lokacionit mund t'i referohen gjerësisë, gjatësisë dhe lartësisë të pajisjes së përdoruesit të fundëm, në drejtim të udhëtimit, në nivel të saktësisë së informacionit të vendndodhjes, në identifikimin e celulës së rrjetit në të cilën ndodhet pajisja e fundme në një pikë të caktuar kohore dhe në kohën kur është regjistruar informata e vendndodhjes.

(15) Komunikimi mund të përfshijë çfarëdo emërtimi, numri apo adresimi të informatës të ofruar nga dërguesi i komunikimit apo përdoruesi i një lidhjeje për ta kryer komunikimin. Të dhënat e qarkullimit mund të përmbajnë çfarëdo përkthimi të kësaj informate nga rrjeti mbi të cilin transmetohet komunikimi me qëllim të kryerjes së transmisionit. Të dhënat e qarkullimit, mes tjerash, mund të përmbajnë të dhëna që i referohen kursit, kohëzgjatjes, kohës apo vëllimit të komunikimit, protokollit të shfrytëzuar, vendndodhjes së pajisjes së fundme të dërguesit apo pranuesit, rrjetit në të cilin buron apo përfundon komunikimi, fillimit, përfundimit apo kohëzgjatjes së një lidhjeje. Ato mund të përmbajnë edhe formatin në të cilin bëhet komunikimi brenda rrjetit.

(16) Informacioni që është pjesë e shërbimit transmetues, i ofruar përmes rrjetit të komunikimit publik synon audiencën potencialisht të pakufizuar dhe nuk përmbanë komunikim në kuptim të kësaj direktive. Sidoqoftë, në rastet kur mund të identifikohet një abonues apo shfrytëzues individual që pranon informacione të tilla, për shembull me shërbimet me video-në-kërkim, informacioni i përçuar mbulohet brendapërbrenda kuptimit të komunikimit për qëllime të direktivës.

(17) Për qëllime të kësaj direktive, pëlqimi i përdoruesit apo abonuesit, pavarësisht nëse ky i fundit është person fizik apo juridik, duhet ta ketë të njëjtin kuptim si pëlqimi i subjektit të të dhënave siç është definuar dhe specifikuar më tej në Direktivën 95/46/EC. Pëlqimi mund të jepet me çfarëdo metode të përshtatshme që mundëson treguesin specifik e të informuar të dhënë lirshëm të dëshirave të përdoruesit, duke përfshirë me aplikimin e një *tiku* brenda kutisë kur të vizitohet një ueb faqe e internetit.

(18) Shërbimet e vlerës së shtuar, për shembull mund të përmbajnë këshilla mbi paketat e tarifave më së paku të shtrenjta, udhëzimin e linjës, informata mbi qarkullimin, parashikimet e motit dhe informacione për turistë.

(19) Aplikimi i disa kërkesave që lidhen me prezentimin dhe kufizimin e thirrjes dhe identifikimin e linjës së lidhur dhe të përcjelljes së thirrjes automatike të linjat e abonuesit të lidhura në këmbimet analoge nuk duhen bërë të detyrueshme në rastet specifike, ku një aplikim i tillë do të dëshmohej teknikisht i pamundur apo do të kërkonte përpjekje ekonomikisht të pabarabartë. Për palët e interesuara është e rëndësishme të informohen rreth rasteve të tilla, prandaj shtetet anëtare duhet t'i denoncojnë ato te komisioni.

(20) Ofruesit e shërbimeve duhet të marrin masat e duhura për ta mbajtur sigurinë e shërbimeve të tyre, nëse ka nevojë në bashkëveprim me ofruesin e rrjetit, dhe t'i informojnë abonuesit rreth ndonjë rreziku të veçantë rreth thyerjes së sigurisë së rrjetit. Rreziqet e tilla mund të paraqiten kryesisht për shërbimet e komunikimeve elektronike përgjatë një rrjeti të hapur, siç është interneti apo telefonia mobile analoge. Për abonuesit dhe përdoruesit e shërbimeve të tilla është veçanërisht e rëndësishme që të jenë plotësisht të informuar nga ofruesi i shërbimeve të tyre rreth rreziqeve ekzistuese të sigurisë, të cilat shtrihen jashtë fushëveprimit të ndreqjeve nga ofruesi i shërbimeve. Ofruesit e shërbimeve të ciltë ofrojnë shërbimeve të komunikimeve elektronike përmes internetit në dispozicion të publikut duhet të informojnë përdoruesit dhe abonuesit rreth masave që mund t'i marrin për ta mbrojtur sigurinë e komunikimeve të tyre, për shembull duke përdorur lloje specifike të softuerëve apo teknologjitë e enkriptimit. Kërkesa për ti informuar abonuesit rreth rreziqeve të veçanta të sigurisë nuk e shkarkon ofruesin e shërbimeve nga obligimi për të ndërmarrë masat e duhura dhe të menjëhershme, me shpenzimet e veta, për të ndrequr ndonjë rrezik të ri e të paparashikuar dhe për ta rikthyer nivelin normal të sigurisë së shërbimeve. Ofrimi i informacioneve për abonuesin rreth rreziqeve të sigurisë duhet të jetë pa pagesë, përveç ndonjë shpenzimi formal që mund ta bëjë abonuesi me rastin e pranimit apo marrjes së informacionit, për shembull duke shkarkuar një porosi nga posta elektronike. Siguria vlerësohet në saje të nenit 17 të Direktivës 95/46/EC.

(21) Masat duhen të ndërmerren për të parandaluar qasjen e paautorizuar në komunikime për ta mbrojtur konfidencialitetin e komunikimeve, përfshirë përmbajtjen dhe çfarëdo të dhëne të lidhur me komunikime të tilla, përmes rrjeteve të komunikimit publik dhe shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut. Legjislacioni nacional në disa shtete anëtare ndalon vetëm qasjen e qëllimshme të paautorizuar në komunikime.

(22) Ndalimi i ruajtjes së komunikimeve dhe të dhënat e lidhura me qarkullimin nga personat tjerë përveç shfrytëzuesve apo pa pajtimin e tyre nuk ka për qëllim ndalimin e çfarëdo ruajtjeje automatike, të ndërmjetme dhe të rastit të këtij informacioni gjersa kjo bëhet vetëm për qëllim të kryerjes së transmetimit në rrjetin e komunikimeve elektronike dhe me kusht që informacioni të mos ruhet për më gjatë se sa është e nevojshme për transmetim dhe për qëllime të menaxhimit të qarkullimit, si dhe se gjatë periudhës së ruajtjes, konfidencialiteti mbetet i garantuar. Kur kjo të jetë e nevojshme për ta bërë efikas transmetimin e mëtejme të ndonjë informacioni të qasshëm publikisht ndaj pranuesve tjerë të shërbimit me kërkesën e tyre, kjo direktivë nuk duhet ta parandalojë një informacion të tillë për t'u ruajtur më tej, me kusht që ky informacion të jetë i qasshëm për publikun për çdo rast pa kufizime dhe që ndonjë e dhënë që i referohet abonuesve apo shfrytëzuesve individualë që kërkojnë informacione të tilla të shlyhet.

(23) Konfidencialiteti i komunikimeve duhet që gjithashtu të jetë i siguar gjatë ushtrimit të ligjshëm të biznesit. Në rastet kur janë të domosdoshme dhe ligjshme të autorizuara, komunikimet mund të regjistrohen me qëllim të sjelljes së dëshmive për transaksionin komercial. Direktiva 95/46/EC aplikohet në përpunimin e tillë. Palët komunikuese duhen informuar rreth regjistrimit, qëllimit dhe kohëzgjatjes së tij para regjistrimit. Komunikimi i regjistruar duhet fshirë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe për çdo rast më së voni në fund të periudhës gjatë së cilës transaksioni mund të sfidohet në mënyrë të ligjshme.

(24) Pajisjet e fundme të shfrytëzuesve të rrjeteve të komunikimit elektronik dhe çfarëdo informacioni i ruajtur në pajisje të tilla është pjesë e sferës private të shfrytëzuesve që kërkojnë mbrojtje sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale. Aplikacionet kundër spiunazhit kibernetik, virusët, identifikuesit e fshehtë dhe mjetet tjera të ngjashme mund të futen në terminalin e shfrytëzuesve pa dijeninë e tyre për t'u qasur në informacione, për të ruajtur informacionet e fshehta apo për të gjurmuar aktivitetet e përdoruesit dhe mundet që seriozisht të ndërhyjë në privatësinë e këtyre shfrytëzuesve. Përdorimi i mjeteve të tilla duhet lejuar vetëm për qëllime legjitime, me dijeninë e përdoruesit në fjalë.

(25) Megjithkëtë, mjetet e tilla, për shembull të ashtuquajturat 'cookies', mund të jenë mjet legjitim dhe i dobishëm, për shembull, në analizimin e efikasitetit të dizajnit të web faqes dhe reklamimit, dhe në verifikimin e identitetit të shfrytëzuesve të përfshirë në transaksionet *on-line*. Kur mjetet e tilla, për shembull *cookies*, përdoren për qëllime legjitime, siç është lehtësimi i sigurimit të shërbimeve të shoqërisë informative, përdorimi i tyre duhet lejuar me kusht që shfrytëzuesve tu ofrohen informata të qarta dhe të sakta sipas Direktivës 95/46/EC rreth qëllimeve të *cookies* apo mjeteve të ngjashme për të siguruar që përdoruesit të njoftohen për informatat e vëna në pajisjen e fundme që ata përdorin. Përdoruesit duhet të kenë mundësinë që ti refuzojnë që të kenë *cookie* apo mjet të ngjashëm të ruajtur në pajisjen e tyre të fundme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur përdoruesit tjerë nga përdoruesi origjinal, kanë qasje në pajisjen e fundme dhe me atë rast në çfarëdo të dhëne që përmbanë informata të ndjeshme rreth privatësisë të ruajtur në një pajisje të tillë. Informacioni dhe e drejta për refuzim mund të ofrohet një herë për shfrytëzim të mjeteve të ndryshme për t'u instaluar në pajisjen e fundme të përdoruesit gjatë lidhjes së njëjtë dhe poshtu mbulimin e ndonjë shfrytëzimi të mëtejme që mund të bëhet prej atyre mjeteve gjatë lidhjeve pasuese. Metodat për dhënie të informatave, duke ofruar të drejtën për të refuzuar apo kërkimin e pëlqimit duhet bërë sa më e lehtë për përdorim që të ketë mundësi. Qasja në përmbajtjen e webfaqeve specifike mund të bëhet me kusht të pranimit të *cookies* apo mjeteve të ngjashme të informuara mirë, nëse përdoret për qëllime legjitime.

(26) Të dhënat që kanë të bëjnë me abonuesit, të përpunuara brenda rrjetit të komunikimeve elektronike për të krijuar lidhje dhe për të transmetuar informata përmbajnë informata mbi jetën private të personave fizikë dhe ka lidhje me të drejtën për ta respektuar për korrespondencën e tyre apo kanë të bëjnë me interesat legjitime të personave juridikë. Të dhënat e tilla mund të ruhen vetëm deri në atë masë që konsiderohet e domosdoshme për ofrimin e shërbimeve me qëllim të faturimit dhe për pagesa të ndërlidhjes edhe atë për kohë të kufizuar. Ndonjë përpunim i mëtejme i të dhënave të tilla, të cilat ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut dëshiron ti kryej, për marketingun e e shërbimeve të komunikimeve elektronike apo ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, mund të lejohen vetëm nëse abonuesi të jetë pajtuar me këtë në bazë të informacioneve të sakta dhe të

plota të dhëna nga ofruesi i shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut rreth llojeve të përpunimit të mëtejme që synon ta kryej dhe rreth të drejtave të abonuesit për të mos dhënë apo për të tërhequr pëlqimin e tij/saj ndaj një përpunimi të tillë. Të dhënat e qarkullimit të përdorura për shërbime komunikimi të marketingut apo për sigurimin e shërbimeve me vlerë të shtuar gjithashtu duhen fshirë apo të bëhen anonime pas ofrimit të shërbimit. Ofruesit e shërbimeve duhet ti mbajnë abonuesit të informuar rreth llojeve të të dhënave që përpunojnë dhe qëlliet e kohëzgjatjen për të cilën bëhet kjo.

(27) Çasti i saktë i përmbushjes së transmetimit të një komunikimi, pas së cilit të dhënat e qarkullimit duhen fshirë përveç për qëllime të faturimit, mund të varet nga lloji i shërbimit të komunikimit elektronik që ofrohet. Për shembull, për një thirrje me zë të telefonisë, transmetimi do të përmbushet sapo njëri prej shfrytëzuesve të përfundojë lidhjen. Për postën elektronike, transmetimi përmbushet sapo që i adresuari të marrë porosinë, në mënyrë tipike nga serveri i ofruesit të shërbimeve.

(28) Obligimi për të fshirë të dhënat e qarkullimit apo për ti bërë ato të dhëna anonime kur nuk duhen më për qëllim të transmetimit të komunikimit, nuk bie në konflikt me procedurat e tilla në internet si vendi i fshehtë në sistemin e emrit të domenit të adresave të ofruesit të internetit apo vendin e fshehtë të adresave të ofruesit të internetit në adresat fizike detyruese ose përdorimi i informatave të kyçjes për të kontrolluar të drejtën e qasjes në rrjete apo shërbime.

(29) Ofruesi i shërbimeve mund të përpunojë të dhëna qarkulluese lidhur me abonuesit dhe përdoruesit kur të jetë e domosdoshme në rastet individuale për të zbuluar dështimet teknike ose gabimet në transmetimin e komunikimeve. Të dhënat e qarkullimit të domosdoshme për qëllime faturimi mund të përpunohet poashtu nga ofruesi për të zbuluar dhe ndaluar gabimin/mashtrimin që përbëhet prej shfrytëzimit e papaguar të shërbimit të komunikimit elektronik.

(30) Sistemet për ofrimin rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike duhen dizajnuar për të kufizuar sasinë e të dhënave personale të nevojshme deri në një minimum të caktuar. Cilatdo aktivitete që lidhen me ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike që e tejkalojnë transmetimin e një komunikimi dhe me atë rast edhe të faturimit duhen bazuar në të dhëna të grumbulluara të qarkullimit që nuk mund të lidhen me abonuesve apo shfrytëzuesve. Kur aktivitetet e tilla nuk mund të bazohen në të dhëna të grumbulluara, ato duhen konsideruar si shërbime me vlerë e shtuar për të cilën kërkohet pëlqimi i abonuesit.

(31) Se a duhet të merret pëlqimi i përdoruesit apo abonuesit për përpunimin e të dhënave personale lidhur me ofrimin e shërbimit me vlerë të shtuar, do të varet nga të dhënat që duhen përpunuar dhe nga lloji i shërbimit që duhet siguruar dhe nëse është teknikisht, proceduralisht dhe kontaktualisht e mundshme që të shquhet individi që e përdorë një shërbim të komunikimit elektronik nga personi fizik apo juridik që është abonuar në të.

(32) Kur ofruesi i shërbimit të komunikimeve elektronike apo shërbimi me vlerë të shtuar nënkontraktin përpunimin e të dhënave personale të nevojshme për sigurimin e këtyre shërbimeve për një entitet tjetër, një nënkontraktim dhe përpunim pasues i të dhënave duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat lidhur me kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave personale siç është përcaktuar në Direktivën 95/46/EC. Kur ofrimi i një shërbimi me vlerë të shtuar kërkon që të dhënat e qarkullimit apo të vendndodhjes të përcillen nga një ofrues shërbimeve të komunikimeve elektronike te një ofrues i shërbimeve me vlerë të shtuar,

abonuesit apo përdoruesit me të cilët lidhen të dhënat gjithashtu duhet informuar plotësisht rreth kësaj përcjelljeje para dhënies së pëlqimit të tyre për përpunimin e të dhënave.

(33) Prezentimi i faturave të specifikuara ka përmirësuar mundësitë që abonuesi të kontrollojë saktësinë e faturave të ngarkuara nga ofruesi i shërbimeve, por në të njëjtën kohë mund ta rrezikojë privatësinë e përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut. Prandaj, për ta ruajtur privatësinë e përdoruesit, vendet anëtare duhet inkurajuar zhvillimin e opsioneve të shërbimit të komunikimeve elektronike, për shembull kartelave thirrëse dhe pajisjet për pagesa me kartela kredie. Shtetet anëtare mund të kërkojnë operatorët që t'u ofrojnë abonuesve një lloj të ndryshëm të faturës së detajuar në të cilin është fshirë një numër i caktuar i shifrave të numrit të thirrur.

(34) Për sa i përket identifikimit të linjës së thirrjes, është e nevojshme që të mbrohet e drejta e palës thirrëse për ndaluar prezentimin e identifikimit të linjës ng e cila bëhet thirrja dhe e drejta e palës thirrëse për ta refuzuar thirrjet nga linjat e paidentifikuara. Ekziston arsyetim për shkeljen e eliminimit të prezentimit të identifikimit të linjës së thirrjes në raste specifike. Disa abonues, në veçanti linjat e ndihmës dhe organizatat e ngjashme, kanë interes në garantimin e anonimitetit të thirrësve të tyre. Për sa i përket identifikimit të linjës së lidhur, është e domosdoshme që të mbrohet e drejta dhe interesi legjitim i palës së thirrur për ta refuzuar prezentimin e identifikimit të linjës me të cilën është lidhur pala thirrëse, sidomos në rastet e thirrjeve të përcjellura. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut duhet ti informojnë abonuesit e tyre për ekzistimin e thirrjes dhe identifikimit të linjës së lidhur në rrjet dhe për të gjitha shërbimet që janë ofruar në bazë të thirrjes dhe identifikimit të linjës së lidhur si dhe për opsionet e privatësisë në dispozicion. Kjo do t'u mundësonte abonuesve për të bërë një zgjedhje të informuar rreth pajisjeve të privatësisë që mund ti përdorin. Opsionet e privatësisë që janë ofruar në bazë të secilës linjë nuk është e thënë që patjetër të jenë në dispozicion si shërbime të rrjetit automatik, por mund të merren përmes një kërkesë të thjeshtë drejtuar ofruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut.

(35) Në rrjetet mobile dixhitale, të dhënat e vendndodhjes që japin pozitën gjeografike të pajisjes së fundme të përdoruesit mobil përpunohen për ta mundësuar transmetimin e komunikimeve. Të dhënat e tilla janë të dhëna të qarkullimit të përfshira në nenin 6 të kësaj direktive. Megjithkëtë, veç kësaj, rrjetet mobile dixhitale mund të kenë kapacitet që ta përpunojnë të dhëna të vendndodhjes që janë më precize se sa duhet për transmetimin e komunikimeve e që përdoren për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, siç janë shërbimet që ofrojnë informacione të individualizuara të qarkullimit dhe udhëzime për vozitësit. Përpunimi i të dhënave të tillapër shërbimet me vlerë të shtuar duhen lejuar vetëm atëherë kur të jepet pëlqimi i abonuesve. Edhe në rastet kur abonuesit japin pëlqimin e tyre, ata duhet të kenë një mjet të thjeshtë për ta mohuar përkohësisht përpunimin e të dhënave të vendndodhjes, pa pagesë.

(36) Shtetet anëtare mund t'i kufizojnë të drejtat e shfrytëzuesve dhe të abonuesve për privatësi për sa i përket identifikimit të linjës së thirrjes kur kjo të jetë e domosdoshme për të gjurmuar thirrjet e bezdisshme dhe për sa i përket identifikimit të linjës thirrëse dhe të dhënat e vendndodhjes kur kjo të jetë e nevojshme për të lejuar shërbimet e emergjencës për të kryer detyrat e tyre në mënyrë sa më efektive që është e mundur. Për këto qëllime, shtetet anëtare mund të aprovonë dispozita të veçanta për t'ju dhënë të drejtë ofruesve të shërbimeve të

komunikimeve elektronike për t'u qasur në identifikimin e linjës thirrëse dhe në të dhënat e vendndodhjes pa pëlqim paraprak të shfrytëzuesve apo abonuesve përkatës.

(37) Për abonuesit duhet siguruar masa mbrojtëse ndaj bezdisjeve, të cilat mund të shkaktohen nga përcjellja e thirrjeve automatike nga të tjerët. Për më tepër, në raste të tilla, abonuesit duhen të kenë mundësinë t'i ndalojnë thirrjet e përcjella që të kalohen te pajisjet e tyre të fundme me kërkesë të thjeshtë për ofruesin e shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut.

(38) Udhëzuesit e abonuesve të shërbimeve të komunikimit elektronik janë publik dhe të shpërndarë gjithandëj. E drejta në privatësi e personave fizikë dhe interesi legjitim i personave juridikë kërkon që abonuesit të kenë mundësinë të vendosin nëse të dhënat personale të tyre duhen publikuar në udhëzues dhe nëse po, cilat prej tyre. Ofruesit e udhëzuesve publikë duhet ti informojnë abonuesit që të përfshihen në udhëzues të tillë rreth qëllimeve të udhëzuesve dhe të ndonjë përdorimi të veçantë që mund të bëhet prej versionet elektronike të udhëzuesve publikë, sidomos përmes funksioneve të kërimit të futura në softuer, siç është kërkitimi prapa i funksioneve që i mundëson shfrytëzuesve të udhëzuesve për ta zbuluar emrin dhe adresën e abonuesit vetëm në bazë të numrit telefonik.

(39) Obligimi për ti informuar abonuesit rreth qëllimit të udhëzuesve publikë në të cilët duhen përfshirë të dhënat e tyre personale, duhen imponuar ndaj palës që mbledh të dhëna për një përfshirje të tillë. Aty ku të dhënat mund të transmetohen te një apo më shumë palë të treta, abonuesi duhet të informohet për këtë mundësi dhe për pranuesin apo kategoritë e pranuesve/marrësve të mundshëm. Çdo transmetim duhet ti nënshtrohet kushteve që të dhënat nuk mund të përdoren për qëllime tjera se për ato për të cilat janë grumbulluar. Nëse pala që grumbullon të dhëna nga abonuesi apo nga ndonjë palë e tretë të cilit i janë transmetuar të dhënat, dëshiron ti përdorë të dhënat për një qëllim shtesë, duhet marrë pëlqimi i përtëritur i abonuesit ose nga pala fillestare që grumbullon të dhënat ose nga pala e tretë të cilit i janë transmetuar të dhënat.

(40) Për abonuesit duhen ofruar masa sigurie ndaj ndërhyrjeve në privatësi nga komunikimet e dhëna për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë në veçanti përmes mjeteve të makinave thirrëse automatike, telefakseve dhe emaileve, përfshirë porositë SMS. Këto forma të komunikimeve të dhëna komerciale në anën tjetër mund të jenë relativisht të lehta dhe të lira për tu dërguar dhe në anën tjetër mund të imponojnë një barrë dhe/apo kosto ndaj pranuesit. Për më tepër, në disa raste vëllimi i tyre mund të shkaktojë edhe vështirësi për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe pajisjeve të fundme. Për format e tilla të komunikimeve të dhëna për marketing të drejtpërdrejtë, arsyetohet kërkesa që para se të merret pajtimi i caktuar i pranuesve par se të t'u adresohen atyre komunikimet e tilla. Tregu i vetëm kërkon qasje të harmonizuar për të siguruar rregulla të thjeshta, që përfshijnë tërë komunitetin për bizneset dhe përdoruesit.

(41) Brenda kontekstit të një marrëdhënieje me konsumatorin ekzistues, është e arsyeshme të lejohet shfrytëzimi i hollësive të kontaktit elektronik për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të ngjashme, por vetëm nga e njëjta kompani që i ka marrë hollësitë e kontaktimit elektronik në pajtim me Direktivën 95/46/EC. Kur të merren hollësitë e kontaktimit elektronik, konsumatori duhet informuar rreth përdorimit të tyre të mëtejme për marketing të drejtpërdrejtë në mënyrë të qartë dhe të dallueshme, dhe ti jepet mundësia për t'a refuzuar një përdorim të tillë. Ky shans



duhet të vazhdojë të ofrohet me çdo mesazh pasues të marketingut të drejtpërdrejtë, pa pagesë, përveç ndonjë kostoje lidhur me transmetimin e refuzimit.

(42) Format tjera të marketingut të drejtpërdrejtë që janë më të kushtueshme për dërguesin dhe imponojnë kosto financiare për abonuesit dhe përdoruesit, siç janë thirrjet telefonike me zë person-me-person, mund të justifikojnë mirëmbajtjen e sistemit që i jep abonuesve apo shfrytëzuesve mundësinë të tregojnë që nuk duan të pranojnë thirrje të tilla. Pavarësisht kësaj, për të mos ulur nivelet ekzistuese të mbrojtjes së privatësisë, shtetet anëtare duhet të kenë të drejtë ti mbështesin sistemet nacionale, duke ua lejuar abonuesve dhe shfrytëzuesve vetëm ato thirrje që kanë dhënë pëlqimin e tyre paraprak.

(43) Për ta lehtësuar zbatimin efektiv të rregullave të komunitetit rreth porosive të dhëna për marketing të drejtpërdrejtë, është e nevojshme që të ndalohet përdorimi i identiteve të rreme apo adresat e numrat kthyes fals gjatë dërgimit të porosive të dhëna për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë.

(44) Disa sisteme të postës elektronike lejojnë abonuesit të shikojnë dërguesin dhe rubrikën e subjektit të postës elektronike, si dhe të fshijnë porosinë pa pasur nevojë të shkarkojnë përmbajtjen e mbetur të postës elektronike apo ndonjë bashkëngjitje, që në këtë mënyrë zvogëlon kostot që mund të lindin nga shkarkimi i postës apo bashkëngjitjeve të dhëna elektronike. Këto rregullime mund të vazhdojnë të jenë të dobishme në disa raste si mjet shtesë për obligimet e përgjithshme të paraqitura në këtë direktivë.

(45) Kjo direktivë nuk paragjykon rregullimet që i bëjnë shtetet anëtare për të mbrojtur interesat legjitime të personave juridikë për sa i përket komunikimeve të dhëna për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë. Aty ku shtetet anëtare u krijojnë personave juridikë regjistrin e metodës së mospranimit të porosive për komunikime të tilla, sidomos shfrytëzuesve biznesore, dispozitave të nenit 7 të Direktivës 2000/31/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 8 qershorit 2000 rreth disa aspekteve ligjore të shërbimeve të shoqërisë informative, në veçanti tregtisë elektronike, në tregun e brendshëm (Direktiva mbi Tregtinë Elektronike) (6) aplikohen në plotni.

(46) Funksionalitetet për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mund të integrohen në rrjet apo në cilëndo pjesë të pajisjes së fundme të përdoruesit, përfshirë edhe softuerin. Mbrojtja e të dhënave personale dhe e privatësisë së përdoruesit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut duhet të jetë e pavarur nga konfigurimi i komponentëve të ndryshëm të nevojshëm për ta ofruar shërbimin dhe të distribuimit të funksionalitetit të nevojshëm midis këtyre komponentëve. Direktiva 95/46/EC mbulon çfarëdo forme të përpunimit të të dhënave personale pa marrë parasysh teknologjisë së përdorur. Ekzistimi i rregullave specifike për shërbimet e komunikimeve elektronike bashkë me rregullat e përgjithshme për komponentët tjerë të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të tilla mund të mos e ndihmojë mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë në mënyrë neutrale për sa i përket teknologjisë. Prandaj mund të jetë e nevojshme për të aprovuar masa që i kërkojnë prodhuesve disa lloje pajisjesh të shfrytëzuara për shërbime të komunikimeve elektronike për ta konstruktuar produktin e tyre në atë mënyrë që të inkorporohen masat mbrojtëse për t'u

siguruar që të dhënat personale dhe privatësia e përdoruesit dhe abonuesit të mbrohen. Aprovimi i masave të tilla në pajtim me Direktivën 1999/5/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 9 marsit 1999 mbi pajisjet radiofonike dhe pajisjeve të fundme të telekomunikimit si dhe pranimin reciprok të përshtatjes së tyre (7) do të sigurojë që hyrja e veçorive teknike të pajisjeve të komunikimeve elektronike, përfshirë edhe softuerin për qëllime të mbrojtjes së të dhënave të harmonizohet që të jetë në pajtim me zbatimin e tregut të brendshëm.

(47) Kur të drejtat e shfrytëzuesve dhe abonuesve nuk respektohen, legjislacioni nacional duhet të kujdeset për kompensime gjyqësore. Penalizimi duhet imponuar ndaj çdo personi, i cili nuk i përmbahet masave nacionale të vëna me këtë direktivë, pavarësisht se a drejtohet nga ligji privat apo publik.

(48) Në fushën e aplikimit të kësaj direktive është e dobishme që të nxjerrë përvojën e Grupit Punues për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit të të Dhënave Personale në përbërje të përfaqësuesve të autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve anëtare, të përcaktuara me nenin 29 të Direktivës 95/46/EC.

(49) Për të lehtësuar përputhjen me dispozitat e direktivës, janë të nevojshme disa rregullime për përpunimin e të dhënave që veçse janë në përpunim e sipër në datën kur hyn në fuqi legjislacioni nacional zbatues sipas direktivës,

MIRATOHET KJO DIREKTIVË:

## **Neni 1**

Fushëveprimi dhe Qëllimi

1. Kjo direktivë harmonizon dispozitat e shteteve anëtare që kërkohen të sigurojnë nivel të barabartë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive fundamentale e sidomos të të drejtës në privatësi, për sa i përket përpunimit të të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik, si dhe të sigurojnë lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla dhe të pajisjeve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik në komunitet.
2. Dispozitat e kësaj direktive specifikojnë dhe plotësojnë Direktivën 95/46/EC për qëllimet e përmendura në paragrafin 1. Për më tepër, ata kujdesen për mbrojtjen e interesave legjitimë të abonuesve që janë persona juridikë.
3. Kjo direktivë nuk aplikohet ndaj aktiviteteve që bien jashtë fushëveprimit të traktatit që ka rrënjosur komunitetin evropian, siç janë ato që mbulohen nga titulli V dhe VI i Traktatit mbi Bashkimin Evropian, e gjithësi ndaj aktiviteteve që kanë të bëjnë me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë e shtetit (përfshirë mirëqenien ekonomike të shtetit kur aktivitetet lidhen me çështjet e sigurisë së shtetit) dhe aktivitetet e shtetit në fushat e të drejtës penale.

## Neni 2

### Përkufizimet

Përkufizimet në Direktivën 95/46/EC dhe në Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 7 marsit 2002 mbi kornizën e përbashkët rregullatore për rrjetet e komunikimeve dhe shërbimeve elektronike (Direktiva Korinzë)(8) aplikohen, përveç në rastet ku është definuar ndryshe.

Të aplikueshme janë edhe përkufizimet në vijim:

- (a) “përdorues” nënkupton çdo person fizik që shfrytëzon shërbimin e komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, për qëllime private dhe të punës, pa u abonuar domosdo në këtë shërbim;
- (b) “të dhëna të qarkullimit” nënkupton çdo të dhënë të përpunuar për qëllime të bartjes së komunikimit në rrjetin e komunikimit elektronik apo për çështje faturimi;
- (c) “të dhëna vendndodhjeje” nënkupton çdo të dhënë të përpunuar në rrjetin e komunikimit elektronik, që tregon pozitën gjeografike të pajisjes së fundme të përdoruesit të shërbimit të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut;
- (d) “komunikim” nënkupton çdo informacion të shkëmbyer apo të bartur midis një numri të kufizuar të palëve përmes një shërbimi të komunikimit elektronik të dispozicion të publikut. Kjo nuk përfshinë çdo inforaci të bartur si pjesë e një shërbimi transmetues të publiku përmes donjë rrjeti të komunikimit elektronik, përveç deri në masën kur informacioni mund të lidhet me abonuesin apo përdoruesin e identifikueshëm që pranon informacionin;
- (e) “thirrje” nënkupton lidhjen e krijuar me mjete të shërbimit telefonik në dispozicion të publikut që mundëson komunikimin e dyanshëm në kohë reale;
- (f) “pëlqimi” i një përdoruesi apo abonuesi përkon me pëlqimin e subjektit të të dhënave në Direktivën 95/46/EC;
- (g) “shërbimi me vlerë të shtuar” nënkupton çdo shërbim që kërkon përpunimin e të dhënave të qarkullimit apo të dhënave të vendndodhjes përveç të dhënave të qarkullimit përtej asaj që është e nevojshme për transmetimit e komunikimit apo faturimit;
- (h) “postë elektronike” nënkupton çdo porosi me tekst, zë, tingull apo pamje që dërgohet përmes rrjetit të komunikimit publik e që mund të ruhet në rrjet apo në pajisjes e fundme të pranuesit deri sa të merret nga pranuesi.

### **Neni 3**

#### Shërbimet e ndërlidhura

1. Kjo direktivë aplikohet në përpunimin e të dhënave personale në lidhje me ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut në rrjetet e komunikimit në komunitet.
2. Nenet 8, 10 dhe 11 aplikohen ndaj linjave të abonuesve të lidhur me shkëmbimet dixhitale, dhe aty ku është teknikisht e mundur dhe nuk kërkohet përpjekje ekonomike joproportionale, ndaj linjave të abonuesve të lidhur me shkëmbimet analoge.
3. Shtetet anëtare e njoftojnë komisionin me rastet ku do të ishte teknikisht e pamundur apo që kërkojnë përpjekje të joproportionale ekonomike për t'i përmbushur kërkesat e neneve 8, 10 dhe 11.

### **Neni 4**

#### Siguria

1. Ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut duhet të marrë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të ruajtur sigurinë e shërbimeve të veta, nëse ka nevojë në lidhje me ofruesin e rrjetit të komunikimeve publike për sa i përket sigurisë së rrjetit. Duke pasur parasysh gjendjen e artit dhe koston e zbatimit të tyre, këto masa do të sigurojnë nivel sigurie të përshtatshëm me rrezikun e prezentuar.
2. Në rast rreziku të posaçëm të prishjes së sigurisë së rrjetit, ofruesi i shërbimit të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut duhet të informojë abonuesit në lidhje me atë rrezik dhe, aty ku rreziku bie jashtë fushëveprimit të masave që duhen marrë nga ofruesi i shërbimeve, për ndonjë lehtësim të mundshëm, përfshirë treguesin e mundshëm të kostove të mundshme.

### **Neni 5**

#### Konfidencialiteti i komunikimeve

1. Shtetet anëtare sigurojnë konfidencialitetin e komunikimeve dhe të dhënat e qarkullimit të lidhura nëpërmjet rrjetit të komunikimit publik dhe shërbimeve të komunikimit në dispozicion të publikut, nëpërmes legjislacionit nacional. Në veçanti, ata duhen ndaluar dëgjimin, ndërhyrjen në bisedë telefonike, ruajtjen apo llojet tjera të përgjimit ose komunikimet e vëzhgimit dhe të dhënat e qarkullimit të lidhura me to nga personat përveç shfrytëzuesve, pa pëlqimin e shfrytëzuesve në fjalë, përveç kur të janë ligjrisht të autorizuar për të vepruar ashtu në pajtim me nenin 15(1). Ky paragraf nuk parandalon ruajtjen teknike e cila është e domosdoshme për bartjen e komunikimit pa paragjykuar parimin e konfidencialitetit.

2. Paragrafi 1 nuk ndikon në ndonjë regjistrim komunikimi të autorizuar ligjërishit dhe të të dhënave të ndërlidhura të qarkullimit kur kryhet në saje të suhtrimit të biznesit të ligjshëm me qëllim të ofrimit të dëshmive të transaksionit tregtar apo të ndonjë komunikimi tjetër biznesor.

3. Shtetet anëtare sigurohen që shfrytëzimi i rrjeteve të komunikimit elektronik ruajtja e informatave apo fitimi i qasjes në informatat e ruajtura në pajisjen e fundme të abonuesit apo përdoruesit lejohet vetëm me kusht që abonuesi apo përdoruesit në fjalë i jepet informacion i qartë dhe i kuptueshëm në pajtim me Direktivën 95/46/EC, mes tjerash rreth qëllimeve të përpunimit, dhe ti ofrohet e drejta për të refuzuar një përpunim të tillë nga kontrolluesi i të dhënave. Kjo nuk parandalon ndonjë ruajtje teknike apo qasje për të vetmin qëllim të kryerjes apo lehtësimit të transmetimit të një komunikimi përmes rrjetit të komunikimit elektronik, apo si e domosdoshme për të ofruar shërbim të shoqërisë informative të kërkuar në mënyrë eksplicite nga abonuesi apo përdoruesi.

## Neni 6

### Të Dhënat e Qarkullimit

1. Të dhënat e qarkullimit që ndërlidhen me abonuesit dhe përdoruesit të përpunuara dhe ruajtura nga ofruesi i rrjetit të komunikimeve publike apo shërbimit të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut duhet fshirë apo të bëhen anonime kur nuk duhen më për qëllime të transmetimit të komunikimit pa paragjykim për paragrafin 2, 3 dhe 5 të këtij neni dhe nenit 15(1).

2. Të dhënat e qarkullimit të nevojshme për qëllime të faturimit të abonuesve dhe pagesave të ndërlidhjes mund të përpunohen. Një përpunim i tillë është i lejueshëm vetëm deri në fund të periudhës gjatë së cilës fatura mund të kundërshtohet ligjërishit apo pagesa të ndiqet.

3. Me qëllim të shërbimeve të komunikimit për marketing elektronik apo për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, ofruesi i shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut mund të përpunojë të dhënat e referuara në paragrafin 1 deri në atë masë dhe kohëzgjatje të nevojshme për qëllime të tilla ose të marketingut, nëse abonuesi apo shfrytëzuesi me të cilin lidhen të dhënat ka dhënë pëlqimin e tij/saj. Përdoruesve apo abonuesve, në çdo kohë u jepet mundësia për ta tërhequr pëlqimin e tyre për përpunimin e të dhënave të qarkullimit.

4. Ofruesi i shërbimeve duhet ta informojë abonuesin apo përdoruesin e llojeve të të dhënave të qarkullimit që përpunohen dhe rreth kohëzgjatjes së përpunimit të tillë për qëllimet e përmendura në paragrafin 2 dhe, para marrjes së pëlqimit, për qëllime të përmendura në paragrafin 3.

5. Përpunimi i të dhënave të qarkullimit, në pajtim me paragrafët 1, 2, 3, dhe 4, duhet kufizuar për personat që veprojnë nën autoritetin e ofruesve të rrjeteve të komunikimit publik dhe shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut që merren me faturime apo

menaxhimin e qarkullimit, hetimin e konsumatorëve, zbulimin e mashtrimeve, shërbimet e komunikimeve elektronike për marketing apo ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, dhe duhet të jetë i kufizuar deri në atë masë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e veprimtarive të tilla.

6. Paragrafët 1, 2, 3 dhe 5 aplikohen pa paragjykuar mundësinë për organet kompetente që të informohen rreth të dhënave të qarkullimit në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm me synim të zgjidhjes së kontesteve, në veçanti kontestet e ndërlidhjes ose të faturimit.

## **Neni 7**

### Faturimi i Detajuar

1. Abonuesit kanë të drejtën e pranimit të faturave të padetajuara.
2. Shtetet anëtare aplikojnë dispozitat nacionale për të koordinuar të drejtat e abonuesve që pranojnë fatura të detajuara me të drejtë në privatësi të përdoruesve që thërrasin apo abonuesve të thirrur, për shembull duke u siguruar që metoda të mjaftueshme alternative të shtimit të komunikimeve apo pagesave të jenë në dispozicion për përdoruesit apo abonuesit e tillë.

## **Neni 8**

### Prezentimi dhe Kufizimi

1. Kur ofrohet prezentimi i identifikimit të linjës thirrëse, ofruesi i shërbimit duhet ti ofrojë mundësinë përdoruesit që thërret, duke shfrytëzuar një mjet të thjeshtë falas për parandalimin e prezentimit të identifikimit të linjës thirrëse për secilën thirrje. Abonuesi që thërret duhet ta ketë këtë mundësi për secilën thirrje.
2. Kur ofrohet prezentimi i identifikimit të linjës thirrëse, ofruesi i shërbimit duhet ti ofrojë mundësinë abonuesit të thirrur, duke përdorur mjete të thjeshta dhe pa pagesë për shfrytëzim të arsyeshëm të këtij funksioni për parandalimin e prezentimit të identifikimit të linjës thirrëse për thirrjet e ardhura.
3. Kur ofrohet prezentimi i identifikimit të linjës thirrëse dhe kur prezentohet identifikimi i linjës thirrëse para krijimit të thirrjes, ofruesi i shërbimit duhet ti ofrojë mundësinë abonuesit të thirrur, duke përdorur mjete të thjeshta, të refuzimit të thirrjeve të ardhura ku prezentimi i identifikimit të linjës thirrëse është parandaluar nga përdoruesi apo abonuesi që e inicon thirrjen.
4. Kur ofrohet prezentimi i identifikimit të linjës së lidhur, ofruesi i shërbimit duhet ti ofrojë mundësinë abonuesit të thirrur, duke përdorur mjete të thjeshta dhe pa pagesë të parandalimit të prezentimit të identifikimit të përdoruesit linjës së lidhur që thërret të.

5. Paragrafi 1 gjithashtu aplikohet për sa i përket thirrjeve në vende të treta që kanë origjinën në komunitet. Paragrafët 2, 3 dhe 4 gjithashtu aplikohen ndaj thirrjeve të ardhura që kanë origjinën në vendet e treta.

6. Shtetet Anëtare sigurohen që aty ku ofrohet prezentimi i identifikimit të linjës thirrëse apo të lidhur, ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut me atër rast informojnë publikun rreth mundësive të përcaktuara në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4.

### **Neni 9**

Të dhënat e vendndodhjes përveç të dhënave të qarkullimit

1. Aty ku mund të përpunohen të dhënat e vendndodhjes përveç të dhënave të qarkullimit, e që lidhen me përdoruesit apo abonuesit të rrjeteve të komunikimit publik apo shërbimeve të komunikimit elektronik në dispozicion të publikut, të dhënat e tilla mund të përpunohen vetëm kur të jenë bërë anonime apo me pëlqimin e përdoruesve apo abonuesve deri në atë masë dhe për kohëzgjatjen e nevojshme për ofrimin e shërbimit me vlerë të shtuar. Ofruesi i shërbimit duhet t'i informojë përdoruesit apo abonuesit, para se ta marrin pëlqimin e tyre, rreth llojit të të dhënave të vendndodhjes përveç të dhënave të qarkullimit që do të përpunohen, për qëllimet dhe kohëzgjatjen e përpunimit dhe nëse të dhënat do të transmetohen te pala e tretë për qëllim të ofrimit të shërbimit me vlerë të shtuar. Përdoruesve apo abonuesve do tu jepet mundësia që në çdo kohë ta tërheqin pëlqimin e tyre për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes përveç të dhënave të qarkullimit.

2. Kur të merret pëlqimi i përdoruesve apo abonuesve për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes përveç të dhënave të qarkullimit, përdoruesi apo abonuesi duhet të vazhdojë të ketë mundësinë duke përdorur një mjet të thjeshtë dhe pa pagesë, për refuzim të përkohshëm të përpunimit të të dhënave të tilla për çdo lidhje në rrjet apo për çdo transmetim të komunikimit.

3. Përpunimi i të dhënave të vendndodhjes përveç atyre të qarkullimit në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 duhen kufizuar për personat që veprojnë nën autoritetin e ofruesit të rrjetit të komunikimeve publike apo shërbimit të komunikimeve në dispozicion të publikut ose të palës së tretë që ofron shërbime me vlerë të shtuar, si dhe duhet kufizuar deri në atë masë sa të jetë e nevojshme për qëllime të ofrimit të shërbimeve me vlerë të shtuar.

### **Neni 10**

Përjashtimet

Shtetet Anëtare sigurohen që të ketë procedura transparente që rregullojnë mënyrën se si ofruesi i rrjetit të komunikimeve publike dhe/apo shërbimit të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut mund të shkelë:

(a) eliminimin e prezentimit të identifikimit të linjës thirrëse, në baza të përkohshme, me rastin e aplikimit të abonuesit që kërkon ndjekjen e thirrjeve qëllimkeq apo bezdisëse. Në këtë rast,

në përputhje me ligjin nacional, të dhënat që përmbajnë identifikimin e abonuesit që bën thirrje do të ruhen dhe vihen në dispozicion nga ofruesi i rrjetit të komunikimeve publike dhe/ose shërbimit të komunikimeve elektronike në dispozicion të publikut;

(b) eliminimin e prezentimit të identifikimit të linjës thirrëse dhe mohimin e përkohshëm apo mungesën e pëlqimit të abonuesit apo përdoruesit për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes për secilën linjë për organizatat që merren me thirrje të emergjencës dhe që njihen si të tilla nga një shtet anëtar, përfshirë këtu agjencitë e zbatimit të ligjit, shërbimet e ambulancës dhe zjarrfikësit, me qëllim të përgjigjes ndaj thirrjeve të tilla.

### **Neni 11**

Përcjellja automatike e thirrjeve

Shtetet anëtare sigurohen që cilido abonues të ketë mundësinë, duke përdorur mjete të thjeshta dhe pa pagesë të ndalimit të përcjelljes automatike të thirrjeve nga pala e tretë deri te pajisja e fundme e abonuesit.

### **Neni 12**

Numratorët telefonikë të abonuesve

1. Shtetet anëtare sigurohen që abonuesit të informohen, pa pagesë dhe para se të përfshihen në numratorë telefonikë, rreth qëllimit të numratorit telefonik të shtypur apo elektronik të abonuesve në dispozicion të publikut apo të arritshëm përmes shërbimeve të kërkimit të numratorit telefonik, në të cilat mund të përfshihen të dhënat e tyre personale dhe për çfarëdo përdorim tjetër të mëtejshëm të bazuar në funksione kërkimi të futur në versionet elektronike të numratorit telefonik.

2. Shtetet anëtare sigurohen që abonuesve tu jepet rasti të vendosin nëse të dhënat e tyre personale të përfshihen në numrator telefonik publik, e nëse po, cilat, deri në atë masë që ato të dhëna janë relevante për qëllimin e numratorit telefonik siç është përcaktuar nga ofruesi i numratorit telefonik, dhe të verifikojë, përmirësojë apo tërheqë të dhënat e tilla. Mospërfishrja në numratorin telefonik të abonuesit publik, verifikimi, përmirësimi apo tërheqja e të dhënave personale nga ai është pa pagesë.

3. Shtetet anëtare mund të kërkojnë që për çfarëdo qëllimi të një numratori telefonik publik përveç kërkimit të hollësive të kontaktimit të personave mbi bazë të emrit të tyre dhe aky ku është e nevojshme, një minimum i identifikuesve tjerë, të kërkohet pëlqim shtesë nga abonuesit.

4. Paragrafët 1 dhe 2 aplikohen ndaj abonuesve që janë persona fizikë. Shtetet anëtare gjithashtu sigurohen, brenda kornizës së ligjit të komunitetit dhe legjisllacionit nacional të aplikueshëm, që interesat legjitimë të abonuesve përveç prsonave fizikë për sa i përket hyrjes së tyre në numratorët publikë të jenë të mbrojtur mjaftueshëm.



## Neni 13

### Komunikimet e pakërkuara

1. Përdorimi i sistemeve automatike të thirrjes pa ndërhyrjen e njeriut (makina automatike të thirrjes), makinat faksimile (fax) apo posta elektronike për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë mund të lejohen vetëm për sa i përket abonuesve të cilët kanë dhënë pëlqimin paraprak.
2. Pavarësisht paragrafit 1, kur një person fizik apo juridik merr nga klientët e tij hollisët e kontaktimit elektronik për postën elektronike, në kontekst të shitjes së produktit apo shërbimit, në pajtim me Direktivën 95/46/EC, i njëjti person fizik apo juridik mund të shfrytëzojë këto hollësi të kontaktit elektronike për marketing të drejtpërdrejtë të produkteve apo shërbimeve të tyre të njëjta, me kusht që klientëve tu jepet mundësia e qartë dhe e dukshme për të kundërshtuar, pa pagesë dhe në mënyrë të lehtë, ndaj përdorimit të tillë të hollësive të kontaktit elektronik kur të mblidhen dhe në rast të secilës porosi në rastet kur klienti fillimisht nuk e ka refuzuar një përdorim të tillë.
3. Shtetet anëtare ndërmarrin masat e përshtatshme që të sigurohen se komunikimet pa pagesë të pakërkuara për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, në rastet përveç atyre që i referohen paragrafëve 1 dhe 2, të mos lejohen ose pa pëlqimin e abonuesve në fjalë ose në lidhje me abonuesit të cilët nuk dëshirojnë ti pranojnë këto komunikime, zgjedhja midis këtyre opsioneve të përcaktohet nga legjislacioni nacional.
4. Për çdo rast, praktika e dërgimit të postës elektronike për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë që mbulon apo fsheh identitetin e dërguesit në emër të të cilit është zhvilluar komunikimi, ose pa adresë të vlefshme në të cilën pranuesi mund të dërgojë kërkesë që komunikimet e tilla ndërpriten, ndalohej.
5. Paragrafët 1 dhe 3 aplikohen ndaj abonuesve që janë persona fizikë. Shtetet anëtare gjithashtu sigurohen, në kuadër të ligjit të komunitetit dhe legjislacionit të aplikueshëm nacional, që interesat legjitimë të abonuesve përveç personave fizikë për sa i përket komunikimeve të pakërkuara të mbrohen mjaftueshëm.

## Neni 14

### Veçoritë teknike dhe standardizimi

1. Në zbatimin e dispozitave të kësaj direktive, shtetet anëtare sigurohen, duke iu nënshtruar paragrafëve 2 dhe 3, që të mos imponohen kërkesa të detyrueshme për veçori teknike specifike ndaj pajisjeve të fundme apo tjera të komunikimeve elektronike, të cilat mund të pengojnë plasimin e pajisjeve në treg dhe qarkullimin e lirë të pajisjeve të tilla në dhe midis shteteve anëtare.

2. Aty ku dispozitat e direktivës mund të zbatohen vetëm duke kërkuar veçoritë teknike specifike në rjetet e komunikimeve elektronike, shtetet anëtare informojnë komisionin në pajtim me procedurën e paraparë me Direktivën 98/34/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 22 qershor 1998 duke shtruar procedurën për ofrimin e informacioneve në fushën e standardeve teknike dhe rregulloreve dhe rregullave mbi shërbimet e shoqërisë informative (9).

3. Aty ku kërkohet, masat mund të aprovohen për të siguruar që pajisja e fundme është krijuar në atë mënyrë që të jetë në përputhje me të drejtën e përdoruesve për të mbrojtur dhe kontrolluar shfrytëzimin e të dhënave personale, në pajtim me Direktivën 1999/5/EC dhe Vendimin e Këshillit 87/95/EEC të 22 dhjetorit 1986 mbi standardizimin në fushën e teknologjisë informative dhe komunikimit (10).

## **Neni 15**

Aplikimi i disa dispozitave të Direktivës 95/46/EC

1. Shtetet anëtare mund të miratojnë masa legislative për të kufizuar fushëveprimin e të drejtave dhe obligimeve të parapara në nenin 5, nenin 6, nenin 8(1), (2), (3) dhe (4), dhe nenin 9 të kësaj direktive kur një kufizim i tillë përbën masë të domosdoshme, të përshtatshme dhe proporcionale brendapërbrenda një shoqërie demokratike për ta ruajtur sigurinë nacionale (dmth. Sigurinë e shtetit), mbrojtjen, sigurinë publike, dhe parandalimin, hetimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale apo të përdorimit të paautorizuar të sistemit të komunikimit elektronik, siç është referuar në nenin 13(1) të Direktivës 95/46/EC. Për këtë qëllim, shtetet anëtare munden, mes tjerash, të miratojnë masa administrative që kujdesen për ruajtjen e të dhënave për një periudhë të kufizuar të arsyetuar mbi bazën e paraqitur në këtë paragraf. Të gjitha masat e referuara në këtë paragraf janë në pajtim me parimet e përgjithshme të ligjit të komunitetit, përfshirë ato të referuara në nenin 6(1) dhe (2) të Traktatit mbi Bashkimin Evropian.

2. Dispozitat e Kapitullit III mbi kompensimet gjyqësore, detyrimet dhe sanksionet e Direktivës 95/46/EC aplikohen në lidhje me dispozitat nacionale të miratuara sipas kësaj direktive dhe në lidhje me të drejtat individuale që kanë dalur nga kjo direktivë.

3. Grupi Punues mbi Mbrojtjen e Individëve për sa i përket përpunimit të të dhënave personale i krijuar me nenin 29 të Direktivës 95/46/EC gjithashtu kryen detyrat e shtruara në nenin 30 të asaj direktive për sa i përket çështjeve të mbuluara nga kjo direktivë, që do të thotë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale dhe të interesave legjitimë në sektorin e komunikimeve elektronike.

## Neni 16

### Rregullimet kalimtare

1. Neni 12 nuk aplikohet ndaj publikimeve të numratorëve telefonikë që veçse janë prodhuar apo vënë në treg në formë të shtypur apo në formë elektronike jashtë rrejtis para dispozitave nacionale të miratuara pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive.
2. Aty ku të dhënat personale të abonuesve në shërbimet me zë të telefonisë fikse apo mobile përfshihen në numratorin telefonik të abonuesit publik në përputhshmëri me dispozitat e Direktivës 95/46/EC dhe të nenit 11 të Direktivës 97/66/EC para dispozitave nacionale të miratuara pas hyrjes në fuqi të kësaj direktive, të dhënat personale të abonuesve të tillë mund të mbeten të përfshirë në këtë numrator telefonik në versionet e shtypura apo elektronike, përfshirë versionet me funksione të kërkimit kthyes, përveç nëse abonuesit tregojnë ndryshe, pas të kenë pranuar informacione të kompletuara rreth qëllimeve dhe opsioneve në pajtim me nenin 12 të kësaj direktive.

## Neni 17

### Zhvendosja

1. Para 31 tetorit 2003, shtetet anëtare fuqizojnë dispozitat e nevojshme për tu përputhur me këtë direktivë. Për këtë ata menjëherë informojnë komisionin.
- Kur vendet anëtare të miratojnë dispozitat e tilla, ato përfshijnë një referencë në këtë direktivë ose shoqërohen nga një referencë e tillë në rast të publikimit të tyre zyrtar. Metodatat e bërjes së referencës së tillë shtrohen nga shtetet anëtare.
2. Shtetet anëtare ia komunikojnë komisionit tekstin e dispozitave të ligjit nacional, të cilin ata e miratojnë në fushën e rregulluar nga kjo direktivë dhe të ndonjë amandament pasues ndaj këtyre dispozitave.

## Neni 18

### Rishikimi

Komisioni paraqet para Parlamentit Evropian dhe Këshillit, jo më vonë se tri vjet pas datës së referuar në nenin 17(1), një raport mbi aplikimin e kësaj direktive dhe ndikimin e saj tek operatorët ekonomikë dhe konsumatorët, në veçanti për sa i përket dispozitave mbi komunikimet e pakërkua, duke marrë parasysh mjedisin ndërkombëtar. Për këtë qëllim, komisioni mund të kërkojë informata nga shtetet anëtare, që duhen ofruar pa vonesa të panevojshme. Aty ku është e përshtatshme, komisioni paraqet propozime për të amandamentuar këtë direktivë, duke llogaritur rezultatet e atij raporti, ndonjë ndryshim në sektor dhe ndonjë propozim tjetër që mund të shihet i nevojshëm për të përmirësuar efikasitetin e kësaj direktive.

## **Neni 19**

Shfuqizimi

Direktiva 97/66/EC me këtë rast shfuqizohet në mënyrë efektive nga data e referuar në nenin 17(1). Referencat e bëra ndaj direktivës së shfuqizuar interpretohen si ti jenë bërë kësaj direktive.

## **Neni 20**

Hyrja në fuqi

Kjo direktivë hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Evropiane.

## **Neni 21**

Të adresuarit

Kjo direktivë i adresohet shteteve anëtare.

Mbaruar në Bruksel, 12 korrik 2002.

Për Parlamentin Evropian

Presidentin

P. Cox

Për Këshillin

Presidentin

T. Pedersen